

NJË FUNDJAVË LETRARE NË TEKSAS

(Promovohen dy libra te poeteve Adnan Mehmeti dhe Ymet Abdullai)

Nga Gjeke Marinaj

Kjo fundjavë ishte diçka me e ngrohtë se ditët e tjera për krijuesit shqiptarë të Teksasit, e veçanërisht për anëtarët e Shoqatës Shqiptaro-Amerikë që banojnë në këtë shtet.

Gjithsesi, ishte një ngrohtësi ndryshe nga ajo e zakonshme, një ngrohtësi, që sjell dhe le mbresa të këndshme në mendjen dhe shpirtin e krijuesëve stimulimi që të zgjon brenda vetes botimi i librave të rinjë, e sidomos, bisedat miqësore të krijuesëve rreth tyre.

Për ta bërë edhe më të këndshëm këtë aktivitet letrar, që pjesëmarrësit e quajtën thjeshtë aktivitet miqësor (pra për miqtë dhe midis miqëve të letërsisë) ishte ftuar nga Nju Jorku edhe z. Ramiz Gjini, Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë.

Takimi i bë në një mjedis të bukur, që përveç atmosferës tërësisht shqiptare, letrare dhe miqësore ndikonte për mirë edhe kënaqësia e dizenjës me shumë shije të restorantit "Roma". Stolisur me një koncept ku mbizotëronte esenca e arkitekturës dhe artit klasik italian, "Roma" për ato pak orë sikur u kthye një urë traditash të pasuara letrare midis artit të madhe të romantizmit italian dhe pasmodernizmit letrar shqiptar.

Ndër të tjera, motivi i këtij takimi ishte edhe ai i pronovimit të dy librave të rinjë: "Shkallë malli për prespën" i poetit Ymet Abdullai dhe librit me të fundit me poema "Ikje nga vetmia" të poetit Adnan Mehmeti, botuar që të dy nga Shtëpia Botuese "Marinaj Publishing".

Fjalën e hapjes e mbajti shkrimtari Ramiz Gjini, i cili i përgëzoi të dy poetët për librat e tyre të sapobotuar. Më pas ai u shpreh se takime të tilla janë një obligim për gjithë krijuesit në diasporë. Ata i japin jetës në emigrim një frymë të mrekullueshme respekti reciprok për njëri-tjetrin dhe njëkohësisht, janë edhe një frymë nxitje drejt krijimeve të reja në të ardhmen. Këto takime, si dhe gjithë fryma e krijimit në përgjithësi, janë një mënyrë e mrekullueshme për tu ngritur si qenje njerzore mbi pamjet e rëndomta të realitetit që servir jeta me përditshmërinë e saj. Ne, tha shkrimtari



Para promovimit



Nga e majta; Ramiz Gjini, Adnan Mehmeti dhe Gjeke Marinaj

Ramiz Gjini, duhet të përpiqemi të ngremë botën tonë shpirtërore në art, mbretërinë tonë kolektive, duke nxjerrë në pah shpirtin e bukur shqiptar. Ai i vlerësoi librat e sapobotuar të dy poetëve Mehmeti dhe Abdullai si një kontribut në

sisë qenë mbledhur në sallën e Muzeut Kombëtarë në Tiranë për të promovuar vëllimin poetik të poetit Adnan Mehmeti "Diellin e kam futur në Xhep". Shumë kritikë të letërsisë, e sidomos prof. Adriatik Kallullit, e patën vlersuar lart krijimtarinë e poetit Adnan Mehmeti për fuqinë shprehëse të vargut, mendimin e ngjeshur dhe muzikalitetin. Edhe shkrimtari Shefqet Dibrani, në pashënjen e librit poetik "Ikje nga vetmia" e ka vlerësuar krijimtarinë e poetit Mehmeti si "një thirrje, një klithje e mesazh kuptimi... Krijuesit në diasporë sikur e ndjejnë më tepër mungesën e gjërave shpirtërore që duhet ta rrethojnë njeriun, ndaj dhe, si për kompensim, ata i plotësojnë këto mungesa me vargjet e tyre. Adnan Mehmeti paraqitet para lexuesit me një vëllim që përçakton fizionominë e formësimit dhe individualitetit krijues" Të pranishmit u njohën edhe me disa artikuj të botuar për poetin Mehmeti në revistat letrare te Maqedonise si Revista "Ura" dhe "Zeri i Pelagonisë"

Poeti Abdullai, falenderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen. Ai falenderoi gjithashtu edhe kolegun dhe mikun e tij Adnan Mehmeti për librin e sapobotuar dhe u përqendrua në rëndësinë që ka në vetvete puna e krijuesve, në mbajtjen gjallë të dashurisë për vendlindjen jo vetëm në letërsinë që ata krijojnë, por edhe në mendjet dhe shpirtin e lexuesëve të tyre.



Ballina e librit të Ymet Abdullait që u promovua në fundjavë në Teksas

aspekti cilësorë në letrat shqipe dhe u uroi atyre, që në të ardhmen të na japin në dorë të tjera vepra artistike.

Një eveniment i veçantë i këtij takimi ishte edhe shikimi në mënyrë të organizuar i një kasete filmike në video, ku shumë dashamirës të letër-



Nga e majta Ymet Abdullai, Gjekë Marinaj, Adnan Mehmeti dhe Ramiz Gjini, përpara restorantit "Roma", ku u shtrua dreka


Poeti Abdullai i ndau vlerat e punës se tij me natyrën e bukur të Prespës dhe me njerëzit e saj që e kanë frymëzuar t'u dedikohet pa rezervë në krijimtarinë e vet. "Unë e kam thënë edhe në libër, tha ai, që bukuritë natyrore janë më tepër fat se sa punë krijuese për një popull, janë këto bukuri natyrore, që na bëjnë të ndihemi edhe më krenarë për origjinin tonë. E kam fjalën për elementin kulturor dhe historik që e ka identifikuar veten që me ullëheqjen e Car Samuillit në shekullin X-të. Po kështu, në aspektin kulturor dhe artistik, hyn këtu edhe Kisha e St. Gjorgjit, e cila gjendet në fshatin Kurbinovë që nga viti 1191. Por gjëja më e bukur, e cila është ndërtaur me djersën e presparëve bashkekohorë, është Xhamija e Kranjës. Në vazhdim, më duket e panevojshme të shtoj, se etja për dije, civilizim dhe përparim njerëzor e ka shoqëruar presparin nga njëri shekull tek tjetri".

Pas kthimit në Dallas, ditën e hënë (28 Qershor) disa nga pjesëmarrësit e shoqëruan z. Gjini tek vendi ku shumë vite më parë ishte bërë atentati që shkaktoi vdekjen e presidenti J.F. Kenedi. Ashtu sëbashku krijues dhe mbështetës të letërsisë shqipe, me emocionet që të sjell një ngjarje e tillë, vizituan edhe Muzeun e ngritur në kujtim të President Kenedit, i cili gjendet në territorin e fatkeqsisë së atëherëshme. Aty vizitorët patën rasiin të niheshin më afër si me literaturën, videot dhe audio kasetat për ngjarjen, ashtu edhe me disa sende të tjera si veshje apo paisje që në ditën e vrasjes President Kenedi kish pasur me vete.

Pas promovimit të dy librave të poetëve Mehmeti dhe Abdullai, një tjetër eveniment ishte edhe takimi me shkrimtarin Kolumbian, profesorin e lingistikës në North - Teksas

në Dallas, njëkohësisht edhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve Kolumbiano-Amerikanë, Prof. Esteban R. Egea.

Kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë Ramiz Gjini e njohu profesorin dhe shkrimtarin kolumbian, Egea, me atmosferën krijuese në komunitetin shqiptar. Ai i foli atij mbi nivelet cilësore të letërsisë shqipe, brenda dhe jashtë Shqipërisë si dhe mbi arritjet e kohëve të fundit, (sidomos pas viteve nëntëdhjetë), arritje këto, që konsistojnë në zhvillimin e një letërsie tjetër, ndryshe nga ajo që pati lulëzuar në shqipërinë postkomuniste, pa mohuar veprat e një numri të vogël shkrimtarësh, që megjithëse në kushtet e një vëzhgimi të rreptë, mundën të bënin letërsi. Gjithashtu, Prof. Egeas iu bë i ditur edhe fakti që gati të gjitha veprat e shkrimtarit të madh kolumbian Gabriel Garcia Marques, janë përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe. Prof. Egeas shprehu dëshirën që në një të ardhme, dëshironte të bënte një vizitë në Shqipëri.



Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve Kolumbiano-Amerikanë, Prof. Esteban R. Egea me të cilin u takua z. Ramiz Gjini, Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë



Çast nga dreka